

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Proces i pandershëm", Ahmeti thirrje Kosovës: Organizohuni, UÇK-ja mbrojt vendin, duhen shpëtuar
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/proces-i-pandershem-ahmeti-thirrje-kosoves-organizohuni-uk-ja-i1185309
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:08:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:02:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2ea3ec12f720a111989c44d30c35a19e50e7ef7b7f03f2fc9ede1e43def9dbc3
TEKSTI	1085b5785ea3fdf9181c79f44d4210638c25bd29babece085eed6b4bb8b9f53e
PAMJA	475c48d899992bfd8c1efc40bc61010dd98f877168d250b30cd29a9bdd59f6af

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8ba986165f8753916782be6cb2fc615b119cd2d426dad36dad7820d27560944f
E MËPARSHMJA	07bdf71f700faca329f4338b7671289952ca78522935fea8ed623c3ff8b2c00b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8ba986165f8753916782be6cb2fc615b119cd2d426dad36dad7820d27560944f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Proces i pandershëm”, Ahmeti thirrje Kosovës: Organizohuni, UÇK-ja mbrojt vendin, duhen shpëtuar

Nga A2 CNN
17 Shtator 2026, 21:02 | Politikë

Një ditë pas vendimit ndaj 4 ish-krerëve të UÇK-së, kreu i BDI-së Ali Ahmeti ka bërë thirrje që të gjithë shqiptarët në Kosovë, Shqipëri dhe jashtë tyre, të organizohen në mbrojtje të këtyre liderëve. Në Off the Record me Andrea Dangllin në A2 CNN ai tha se procesi ndaj tyre ishte i padrejtë dhe i tjetërsuar nga qëllimi dhe prandaj kjo betejë duhet fituar.

“Ky proces ka degraduar nga qëllimi. Ky proces është hapur ndaj shtetpësisë së verdhë ku aktorë antishqiptarë si në Beograd dhe në Moskë kanë dashur të implikojnë tërë kombin shqiptar në këtë luftë që edhe Shqipëria është pjesëmarrëse në akte barbare siç ishte akuza për tregtim me organe njerëzore. Kështu që jo vetëm Kosova, por edhe Shqipëria, edhe shqiptarët jashtë Kosovës si në Maqedoni që nuk janë një minoritet i vogël, duhet ta ngrënë zërin sepse u devijua ky proces nga ai i fillimit i Dik Martit që mbajti ligjëratë dhe arsyetoi përpara Këshillit të Evropës se gjoja se shqiptarët kanë bërë luftë të pandershme dhe kanë kryer krime ndaj njerëzve të pafajshëm. Kështu që ne duhet tani të udhëhiqemi nga racionaliteti e arsyeja. Ne duhet ta fitojmë këtë betejë dhe me një betejë të humbur apo të fituar, nuk fitohet lufta. Betejë pas betejë lufta fitohet. Tani beteja e radhës është që autoritetet e Kosovës e kanë përgjegjësinë në radhë të parë si qeveria, parlamenti të organizohen mirë në të gjitha drejtimet në diplomaci dhe në drejtësinë ndërkombëtare që ky proces i pandershëm dhe i tjetërsuar nga qëllimi të marrë epilog”, theksoi ai në Off the Record me Andrea Dangllin në A2 CNN.

Ahmeti thekson se duhet të vihet në lëvizje e gjithë diplomacia e Shqipërisë dhe e Kosovës për të dalë triumfues në Apel.

“Unë mendoj që shqiptarët duhet të jenë mirë të organizuar, institucionet e Kosovës. Shqipëria mund të ndihmojë shumë në këtë drejtim si kryeministri, si ministri i jashtëm të vihet në lëvizje e tërë diplomacia e Shqipërisë, e tërë diplomacia e Kosovës. Kështu që ka gjykatë të apelit dhe në apel ne duhet të dalim triumfues, të dalë e vërteta dhe të gjykohej fillimi i procesit. Fillimi i procesit është shtëpia e verdhë. Tani është devijuar i tërë procesi me akuza të sajura”.

Sipas Ahmetit Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ushtri vullnetare e organizuar për t'u mbrojtur nga masakrat e mirëorganizuara dhe të përgatitura, jo vetëm nga Millosheviçi.

“Por historikisht jetësoheshin në '98-99ë-n Platforma e Çubrilloviçit, platforma e Grashaninit, platforma e Nikolla Pashiqit që ka qenë kryeministër për gjashtë mandate i Serbisë dhe për tre mandate i mbretërisë gjuhës sllave për pastrim etnik të shqiptarëve. Nëse nuk arrijnë dot spastrimin, atëherë të përdorin bajonetën dhe t'i zhdukin fizikisht shqiptarët duke shpallur fajtorët në radhë të parë nënën shqiptare”.

TE FUNDIT

“Lirinë e kemi larë me gjak”, Ahmeti: Duhet t'i jemi mirënjohës Amerikës që e bëri Kosovën shtet

“Jam i indinjuar me Kurtin”, Ahmeti: Informohu, gjuha shqipe është e sanksionuar në Maqedoninë e Veriut nga Marrëveshja e Ohrit

Ali Ahmeti: As gjykatat e Millosheviçit s'do ta kishin dhënë këtë dënim për krerët e UÇK-së

Sot Europa League me 9 sfida. Vëmendja te Juventusi, në fushë Real Sociedad-Bournemouth

MË TË VIZITUARAT

"M'u duk mizori ndaj Thaçit", ish-hetuesja e Millosheviçit: Ndihejmi në krijim...

"Janë bërë gabime të rënda ligjore", avokatët e Thaçit do të apelojnë vendimi...

Ish-hetuesja e Millosheviçit: Haga nuk u krijua kurrë për të dhënë drejtësi...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Ai thekson se “këta luftëtarë janë dënuar nga sistemi dhe regjimi i kaluar. Jakup Krasniqi ka qenë dhe ka vuajtur 12 vite burg në burgjet e Jugosllavisë. Hashim Thaçi, Kadri Vesili, Rexhep Selimi kanë qenë të dënuar me vite të tëra nga regjimi i Millosheviçit, ashtu siç janë dënuar shumë e shumë ushtarë, patriotë të nderuar”.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Haga unifikon Tiranën, krah Prishtinës deklarata e Kuvendit: Nuk rishkruhet historia e një populli



Pagat e magjistratëve, PD kërkon më shumë konsultime, PS e quan hipokrizi dhe nuk tërhiqet



“Jam kërcënuar, por nuk kam frikë”, Dash Sula: Rama më riktheu dinjitetin



“UÇK lindi si përgjigje ndaj gjenocidit të Millosheviçit”. Kuvendi del me deklaratë pas vendimit të Gjykatës Speciale



KAYO dhe trafiku i armëve, PS refuzon kërkesën e PD për komision hetimor: Nuk ka indicie



Berisha paralajmëron Peleshin: E ke zëvendësin gati

Latest Videos



"Sa herë je marrë me ne, na ke dëmtuar"deputeti Kurtit shpërthen ndaj Ramës: Mos u përziej në Kosovë



"Tradhti kombëtare", shpërthen deputeti i Kurtit: Rama s'duhet ta kishte votuar Gjykatën Speciale



"Absurde", deputeti i LVV: Arsyetimi i vendimit për krerët e UÇK-së i bazuar në thashetheme



"Situatë jashtëzakonisht e rrezikshme", paralajmëron ish-ambasadori: Serbët po inkurajohen të bëjnë

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulo

Imagjinatë

Dëshmi

Facebook

Twitter

Instagram

YouTube

A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediaset

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.